



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 3305 Prot.

Tiranë, më 04.12 .2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 134 datë 04.12 .2023

PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS  
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS DHE  
UNIVERSITETIT TË FINLANDËS JUGLINDORE NË SHKENCAT E APLIKUARA

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, si dhe në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Senati Akademik me Vendim Qarkullues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe **Universitetit të Finlandës Juglindore në Shkencat e Aplikuara**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.

*Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.*

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. **AGRON KASA**

